



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.SH.II.nr.524/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SHA me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr.76/22 të datës 21.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SHA me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative K.A.nr.76/22 i datës 21.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, është Refuzuar si e bazuar Kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SHA nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.V_1018_2018 i datës 20.08.2018 i paditurit Zyra e Rregullatorit per Energji në Prishtinë.

Kundër këtij Aktgjykimi, pala paditëse, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.76/22 të datës 21.10.2023 si i kundërligjshëm, Aprovohet kërkespadia e paditësit dhe Anulohet vendimi i ZRRE-së, V_1018_2018 i datës 20.08.2018, si i paligjshëm.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave e paditura Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me vendimin kontestues V_1018_2018 datës 20.08.2018, ka vendosur si në vijim: I. Aprovohet mesatarja e ponderuar të kostos së kapitalit, e cila do të jetë 8.3% reale, përkatësisht 10.2% nominale (përfshirë inflacionin e supozuar prej 1.9% i cili gjatë azhurnimeve vjetore do të llogaritet ashtu siq është përcaktuar në Rregullat për vendosjen e të hyrave) për periudhën e dytë rregullative 2018-2022, me supozimin se leverazhi (gearing-u) është 40%, II. Mesatarja e ponderuar e kostos së kapitalit e përcaktuar në pjesën I të këtij dispozitivi, është e njëjtë për operatorin e sistemit të transmetimit dhe tregut dhe operatori i sistemit të shpërndarjes.

Paditësi ndaj këtij vendimi përfundimtar në procedurën administrative, me padinë e datës 20.09.2018 ka inicuar në gjykatë, konflikt administrativ kundër të paditës, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padisë dhe anulimin e vendimit të paditës, si i kundërligjshëm.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, me Aktgjykimin K.A.nr.76/22 datës 21.10.2022 ka Refuzuar kërkespadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi nr.V_1018_2018 datës 20.08.2018 i paditurit Bordi të Zyrës së Rregullatorit për Energji në Prishtinë.

Dhoma e shkallës së parë në arsyetimin të aktgjyimit thekson se e paditura ZRRE në realizimin e detyrave dhe përgjegjësisve ligjore ka zhvilluar proces transparent duke përfshirë konsultimin me palët e interesit dhe shqyrtimin e vlersimit të komenteve si dhe ka vlersuar faktorët financiar dhe ekonomik me ndikim për të vendosur parametrat për të përcaktuar mestarën e ponderuar të kostos së kapitalit në nivelin 8.3% me vendimin e kontestuar. Gjendjen e konstatuar faktike gjykata e vlersoj në bazë të Raportit konsultativ i shqyrtimit të pestë i tarifave të energjisë elektrike dt.22.02.2011, 22.03.2013 i përgaditur nga ZRRE, dhe ZRRE ka hartuar raport përfundimtar në përgjigjen e KEDS si mbajtës i licencës së operatorit të sistemit të shpërndarjes në lidhje me vlersimin e mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit për periudhën e dytë rregullative 2018-2022. Gjykata vleron se ZRRE duke vepruar si autoritet rregullativ sipas Ligjit 05/L-085 për Energji Elektrik, në mënyrë të drejtë dhe në një proces transparent ka vlersuar se parametrat e përcaktuar 8.3% i mundëson paditësit KEDS investime të nevojshme në mënyrë që i garanton stabilitetin e investimeve dhe kthimin e investimeve.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale të Kosovës, këtë qëndrim juridik të dhomës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me vërtetimin të gabuar të gjendjes faktike apo zbatim të gabuar të drejtës materiale, sikurse pretendon paditësi në ankesë.

Pretendimet ankimore të paditësit se vendimi i kontestuar si akt administrativ nuk e ka përmbajtjen e aktit administrativ që parashihet me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, gjykata gabimisht ka vlersuar provat, kur ka vlersuar se ZRRE ka zhvilluar proces transparent pasi që paditësi kishte dorëzuar vërejtje komente të mbështetura nga raportet e përgaditura nga ekspertët e pavarur siq janë analiza nga Deloitte e datës 06.09.2017, se me vendimin e kontestuar paditësi është i diskriminuar me rastin e përcaktimit të mesatares së ponderuar, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, i refuzoi si të pabazuara këto pretendime, ngase aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë nuk ka të meta në aspektin e vërtetimit të gjendjes faktike, për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjyimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjyimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse

për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e Shkallës së Dytë.

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlerësoi se vendimi kontestues i të paditurës i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ që parashihet me nenin 47 dhe 48 të LPP-së. Gjithashtu Kolegji nuk gjeti prova për të cilat paditësi pretendon se me vendimin kontestues është diskriminuar me rastin e përcaktimit të mesatares se ponderuar te koston se kapitalit në 8.3% për periudhën rregullative 2013-2017, për arsye se mesatarja e aprovuar e ponderuar e koston së kapitalit nga i padituri, ka ardhur si rezultat i vlerësimit të parametrave hyrës për periudhën e dytë rregullative 2018 dhe 2022, janë përgatitur raportet konsultative, dhe analiza krahasimore me kompanitë që operojnë në industrinë e ngjashme në Evropë, dhe regjion. Kolegji nuk ka mund të vërtetoj se mesatarja e koston së kapitalit është diskriminuese në raport me paditësin pasi që përcaktimi i kësaj mesatare është e njëjtë si për operatorin e sistemit të transmisionit që operohet nga KOST-i, ashtu edhe për operatorin e sistemit të shpërndarjes që operohet nga KEDS-i.

Kolegji vlerësoi se me të drejt Dhoma e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për anulimin e vendimit nr.V_1018_2018 i datës 20.08.2018 i paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, pasi që aktgjykimi i ankimuar dhe vendimi i të paditurit gjejnë mbështetje ligjore në dispozitat e Ligjit 05/L-085 për Energjinë Elektrike dhe Rregullës për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Tregut, duke vendosur parametrat e përcaktuara në 8.3%, në proces transparent.

Andaj Dhomat e Shkallës së Dytë, gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankes, Dhoma e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 44 të LKA-së dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Kolegji i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë, mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.524/24 datë 18.04.2024

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
Krenar Berisha